



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0212

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Agon Ramadani - Kryetar, Vedat Poterqoi - Anëtar, Vjosa Gradinaj- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së (GOE) “Eor Group” sh.p.k & “Contanti Generators”, me seli në Prishtinë, e parashtruar, kundër vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Gjenerator” me nr. të prokurimit: 651-22-12442-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna e Gjilanit, më 21.07.2023, morri këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE Eor Group SH.P.K. me nr. 2023/0212 , e datës 15/04/2023, kurse vendimi i AK KUVENDI KOMUNAL- GJILAN lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me Gjenerator me numër të prokurimit 651-22-12442-1-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Eor Group SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Komuna e Gjilanit, në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 17.11.2022, ka publikuar Njoftimin për Kontratë, Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ishte me datë 29.11.2022. Me datë 31.03.2023, ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të Kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Gjenerator”, me numër të prokurimit 651-22-12442-1-1-1, ku është rekomanduar për kontratë, OE “Infinit” sh.p.k. Prishtinë.

Me datë 04.04.2023, OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim, me datë 06.04.2023, AK Komuna e Gjilanit, refuzon si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të grupit të Operatoreve Ekonomik “Eor Group” sh.p.k & “Contanti Generators”, për aktivitetin e prokurimit të sipër shënuar.

I pakënaqur me vendimin e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim, GOE “Eor Group” sh.p.k & “Contanti Generators” me seli në Prishtinë, me datën 18.04.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP me numër të protokollit 212/23.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë t? hapur - furnizim, vlerë të madhe, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimi më të ulët vlera e parashikuar e kontratës: 160,350.00 €.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 03 maj 2023 me raportin e ekspertizës. Me datë 03.05.2023, AK Komuna e Gjilanit, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq me datë 06.05.2023, GOE “Eor Group” sh.p.k & “Contanti Generators”, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 05 maj 2023 ka rekomanduar që:

- Refuzohet si e pa bazuar ankesa e “Eor Group” sh.p.k & “Contanti Generators”, me seli në Prishtinë.
- Të mbetet në fuqi vendimin e AK-së i datës 31.03.2023 (*vendim për dhënie të Kontratës*).

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të merret si e pabazuar dhe Vendimi mbi autoritetin kontraktues të mbetet në fuqi.

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij nuk janë të pranueshme nga ana e këtij paneli për faktin se i njëjti nuk është përgjigjur pretendimeve ankimore e po ashtu nuk ka prezantuar të gjetura, hulumtime dhe analizë konkrete në relacion me pretendimet ankimore si dhe konform legjislacionit në fuqi, dhe si rrjedhojë paneli vendosi që ankesa GOE ankues “Eor Group” sh.p.k & “Contanti Generators” të aprovohet si e bazuar dhe që aktiviteti i sipërshënuar të kthehet në rivlerësim si shkak i arsyeve

të dhëna si më poshtë.

Vlen të theksohet se lidhur me këtë aktivitet prokurimi OSHP ka lëshuar edhe një vendim lidhur me aplikimin e nenit 10 të LPP-së, me të cilin është obliguar AK që OE ankues ti ofrojë qasje në dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë konform dispozitave në fuqi, ndërsa ankesa si objekt shqyrtimi tanimë përmban pretendimin parimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kriterin si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, 9.1 & 9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional, Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme gjatë 3 vitet e fundit. Në një vlerë prej jo më pak se 200.000,00 €. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve me sukses.

Lidhur me këtë çështje, përkundër faktit që pala ankuese pretendimin ankimor të ngjashëm e ka paraqitur edhe në ankesën e kaluar, PSH ka arritur në konstatimin se, bazuar në shkresat e lëndës, PSH nuk ka arritur të evidentojë arsyetimin e AK-së se si plotësohet kriteri relevant, ndërsa nuk ka ofruar përgjigje konkrete në refuzimin e kërkesave për rishqyrtim, në raport me pretendimin e paraqitur ankimor, ndërsa kundrejt këtij pretendimi nuk është përgjigjur në mënyrë argumentuese as eksperti i angazhuar në këtë rast, andaj këto veprime të AK-së konsiderohen se bien në kundërshtim me nenin 108/A në të cilin saktësohet se përgjigjja në refuzim duhet të arsyetohet në detaje, andaj rrjedhimisht në këtë rast konstatohet se AK nuk ka bërë ekzaminimin e tenderëve në harmoni me nenet 59, 60 dhe tiparet themelore të LPP-së, për faktin se nuk ka qartësuar se cilat kontrata janë të pranueshme, cilat konsiderohen si të ngjashme me aktivitetin konkret.

Lidhur me këtë, bazuar në shkresat e lëndës, PSH ka evidentuar se OE i rekomanduar ka paraqitur një listë të kontratave në të cilën paraqiten 262 kontrata, në të cilat janë evidentuar 4 (katër) kontrata të furnizimeve me gjenerator, që arrijnë vlerën e përgjithshme prej 18,966 euro, në të njëjtën kohë AK në kuadër të komisioneve vlerësuese nuk ka arsyetuar ngjashmërinë e kontratave tjera, andaj obligohet AK që gjatë procedurave të rivlerësimit të bëjë vlerësimin e ofertave në raport me këtë pretendim si dhe kriterin e kërkuar me të cilin saktësohet se duhet të konsiderohen vetëm kontratat e përfunduara në 3 vitet e fundit (nga data e njoftimit për kontratë), e poashtu duke u bazuar në të gjitha si u thanë si më sipër.

Paneli shqyrtues vlerëson se bazuar në rastet me situata të ngjashme me rastin aktual, të shqyrtuara nga bordi aktual i OSHP-së, si çështje përcaktuese që krijon lidhshmëri lidhur me disa pretendime ankimore të OE ankues është çështja e klasifikimit të natyrës së ngjashme të punëve/shërbimeve, PSH konsideron se si pika përcaktuese në rastet kur AK nuk saktëson në kërkesa të DT dhe NJK se cilat kontrata konsiderohen të ngjashme me aktivitetin konkret (duke dhënë shembuj), bazuar në rastet e kaluara që si rrjedhojë kanë pasur pretendime të ngjashme/njëjta, vendimmarrja sa i përket këtyre çështjeve është arritur duke analizuar punët/shërbimet që parashikohen të zbatohen, qoftë në paramasë apo projekt-dizajn të aktivitetit, e pastaj krahasimi i tyre me punët/aktivitetet e përcaktuara në kontratat e referuara si dhe aktivitetin përkatës, kështu që lidhur me rastin tonë, duke qenë se AK nuk ka dhënë shembuj se cilat shërbime/punë konsiderohen të ngjashme, shpjegimet për pranimin apo mos-pranimin e të njëjtave duhet që ti arsyetojë në vendimin që do ta nxjerrin si rezultat i rivlerësimit.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - Eor Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: